VENDIM
Nr. 505, datë 30.7.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 17 të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korrente, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin 02120 "Forcat e luftimit" të shtohet 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë;

b) Në programin 09430 "Arsimimi ushtarak" të pakësohet fondi 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë;

c) Në programin 02150 "Mbështetja e luftimit" të pakësohet fondi 129 000 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë) lekë;

ç) Në programin 02280 "Bashkëpunimi civilo-ushtarak (AL - CIMIC)" të pakësohet fondi 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama